



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërmëdhjetë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **26.04.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 16. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 9. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 10. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 23. <u>Qerim Rexhaj, VV;</u> |
| 11. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 25. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 26. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=P9TdDaGYWeE> : "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova - përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Prezanton organizatën DEMOS dhe qëllimin e monitorimit të së anëtarëve të Kuvendit të komunës për dhjetë muaj radhazi. Fjalën ja kalon z. Naim Cahaja - DMOS.

DMOS, z. Naim Cahaja - përshëndeti të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e programit të monitorimit për matjen e performances dhe angazhimit tuaj gjatë periudhës Majë - shkurt 2024.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova - Hap punimet për mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes njëzet e pesë (26) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë me mbledhjen ;

R E N D D I T E

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2023;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga viti 2022, nga fondi burimore 22,
5. Shpallja në diskutim publik e Projekt - Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Punës në Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (SHPMPPF).
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi?

Florin Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kërkoj një sqarim nga ju z. Kryesues rendi i ditës ka ndryshuar, dua ta di pse nuk është respektuar plan programi i punës së kuvendit të cilin e kemi votuar këtu për vitin 2023.

Kryesuesi i Kuvendit - faleminderit z. Florin çështjen e pronave komunale e kemi lenë të hapur për një mbledhje ku ka me pak pika të rendit të ditës dhe po besoj që edhe ata që kanë qen aty në formulimin dhe kompletimin e planit të punës së kuvendit për vitin 2023, nuk e kemi lenë në prill por në një muaj ku ka me pak pika të rendit të ditës, kjo nuk është hekur nga rendi i ditës ka edhe pika tjera në Planin e punës edhe nuk kanë hyrë në rend dite nuk është e vetmja.

Florin Dreshaj – nuk është e vërtetë që nuk është e cekur në planë është: Njoftimi me kontratat e pronës së paluajtshme të komunës (Banesat, Objektet afariste dhe tokat bujqësore). Ne e kemi votuar këtë pik diskutimi rreth pronave bujqësore të komunës së Istogut e dim që i ka rreth 700 hektar dikund dhe për mbi dhjet vite mbillen nga dikush punohen ato toka mbillen me kultura bujqësore ndërsa komuna e Istogut prej 700 hektarëve nuk e inkason as një cent këtu në mbledhje e kemi futur për muajin prill ndërsa në mbledhjen e komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit e kemi fut piken e parë siç e ceka me lartë, nuk është e vërtetë ajo që po thonë ju që e kemi lenë në një mbledhje që nuk ka shumë punë ose nuk ka shumë pika të rendit të ditës janë dëshmitar të gjithë këta, asamblastë që kanë votuar atë mbledhje . prandaj ju lutem që ta tregoni arsyen e vërtetë pse është hekur ose pse është censuruar rendi i ditës për sot.

Kryesuesi i Kuvendit – po me duket që kesh shumë i qartë Florin dhe nuk po dua të merrem me këtë situatë ajo do të jetë një nga mbledhjet kur të jetë me pak e ngarkuar.

Florin Dreshaj – ta bëj unë Planin e punës së Kuvendit që është kjo pikë.

Kryesuesi i Kuvendit – po ne dikund është dashur me e cek këtë pikë. Kjo pik do të jetë në një mbledhje po ta shikojmë se kur do ta kemi, sepse ekzekutivi nuk ka qenë i përgatitur, kjo pik nuk do të dalë nga plani.

Florin Dreshaj – nuk keni të drejt me e ndryshuar planin e punës aty diçka po mshëfjet ato prona po zhvaten nga njerëzit e juaj dhe ju e dini shumë mirë kush janë, e nuk është e drejt që po mundohesh më me qit mu se po mundona mete zen ngushtë ose mete qit në lajthitje, se nuk mundona me e qit në lajthitje kërkon, interesi jonë ka qenë që ato prona të hin në sistem të epen me qira pronat bujqësore të përfitoj edhe dikush prej tyre, edhe të përfitoj edhe komuna jonë. Ju nuk po doni me i qit nuk e di a po përfitoni vet apo janë njerëz me të fort se komuna dhe nuk po guxon me i qit këto janë dy arsye.

Kryesuesi i Kuvendit – aty është mendimi juaj ka edhe instanca tjera me i denoncuar jo vetëm në asamble në asamble do të del kjo pikë.

Florin Dreshaj – cakto kur do të jete kjo pik të dim kur?

Kryesuesi i Kuvendit – ta shohin kur të jetë mbledhja me pak e ngarkuar . ta ndërprejmë tani këtë bisedë se po mbesim krejt këtu.

Florin Dreshaj – pasi po e ndërprejmë unë si asamblastë i grupit të VV largohem nga mbledhja sepse nuk dua të marr pjesë në këtë mbledhje me një rend dite të cenosura, do të vazhdojnë masa tjera demokratike dhe nuk do të mund të fshihni ta dini.

Kryesuesi i Kuvendit – askush nuk është duke fshehur asgjë shumë transparent jemi shumë me sinqeritet, konform ligjeve në fuqi jemi. `

A ka dikush tjetër diçka?

Kam unë në rekomandim nga MAPL në lidhje me Planin Lokal të Veprimit për Transparencë të votohet edhe përmirësimi sipas modelit nga MAPL.

Kryesuesi i Kuvendit – hedhe në votim, piken e rendit të ditës
Miratohet me 19 vota për , 4 abstenime.

Hedh në votim rendin e ditës

Miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje me 14 vota për, 8 vota kundër dhe 1 vota abstenim.

Konstatohet që me 23 anëtar janë prezent

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në mbledhje mungojnë: Veton Kurtaj, ka lajmëruar që nuk mund të vijë, edhe është Qerim Rexhaj për shkaqe shëndetësore nuk mund të marr pjesë në mbledhje.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit – Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Pasi q nuk keni diçka,

Hedh në miratim

Miratohet unanimit

Konstatohet që me 21 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 26.04.2023 pa vërejtje.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken e radhës, Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2023. A ka dikush diçka?

Drejtor për Zhvillim Ekonomi – Buxhet e Financa z. Genc Ademaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2023.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, rreth këtij raporti është par se ka shumë projektet të cilat janë të domosdoshme duke përfshirë edhe projekte të vogla të mesme dhe të mëdha të listuar që unë i kam par që janë të bartura dy a tri here i njëjti projekt me të njëjtin kod ekonomik por ka edhe projekte që e kanë të njëjtin kod por i kanë dy shuma të ndryshme të cilat unë i kam nxjerrë: ndërtimi i tregut të ri në Istog me vlerë 175 mijë euro është proceduar dy here sa i përket ndërtimit të trotuarit Baic – Kashic – Saradran kjo është në rregull por ndërtimi i kanalizimit në Mojtir me vjen shumë mirë që Mojtiri ma në fund ka hy në rang listë për të përparuar diçka projekt me numër 53356 Ndërtimi i kanalizimit në Mojtir fillimisht e ka vlerën 30mije euro po me të njëjtin kod janë edhe 10 mijë euro. Tani e kemi rregullimin e shtratit të lumit të Istogut edhe kjo e ka një kod por i ka dy a tri vlere prej burimit e deri të... ashtu është e evidentuar pra ka 150 mijë euro e ka një vlere me të njëjtin kod e ka edhe një vlerë tjetër 180 mijë euro.

Drejtor për Zhvillim Ekonomi – Buxhet e Financa z. Genc Ademaj – sqaron rreth pyetjeve të bëra janë dy burime financimi dhe mjetet janë marr nga dy burime financimi.

Ajshe Metaj – projekti Xhelbrimi NB edhe ky e ka një vlerë prej 100 mije euro, nuk e kuptova me u specifikuar.

Drejtor për Zhvillim Ekonomi – Buxhet e Financa z. Genc Ademaj – tabela e programit që kemi punuar nuk e qet komplet emrin e projektit duhet me i ranu përmbi, por të ligji i buxheti është emri i projektit edhe shuma komplet.

Ajshe Metaj – herëve të kaluara kemi pasur një projekt rrethimi i mureve mbrojtës dhe zhveshtorëve të stadiumit “Demush Mavraj,, kanë qen 90 mijë euro. Jan përsërit të njëjtat a është vazhdim i projektit.

Drejtor për Zhvillim Ekonomi – Buxhet e Financa z. Genc Ademaj – sqaron rreth projektit.

Hajrush Shoshi - përshëndet të gjithë të pranishmit, dua ta bej një pyetje rreth të punësuarve në arsim ku po del – 5 ku donë me thëne që janë pese mësimdhënës me shumë se sa që është planifikimi a marrin këta mësimdhënës paga apo jo.

Drejtor për Zhvillim Ekonomi – Buxhet e Financa z. Genc Ademaj – unë e sqarova edhe me herët këtë çështje, këto janë edhe për shkak të pushimeve të lehonisë se së bashku me zyrtaren e buxhetit.

Ajshe Metaj – edhe ne jemi të vetishëm që u mbyll buxheti por faktikisht këto janë shpenzime për tre muajt e parë dhe mbi ata se çka unë diskutova, nuk thash të shtihen projekte te reja në kuadër të këtij buxheti se ne e dimë mirë se një here duhet me i planifikuar të hollat e pastaj me i bë projektet. Vetëm thash në të ardhmen të behet prioriteti i projekteve kapitale dhe shtrirja e tyre e di kur mbyllet buxheti dhe e i që është TM1-shi 2023.

Niman Beqiraj – të mallrat dhe shërbimet e pash që përqindja e shpenzimeve në raport me alokimet ke 17.49% vitin e kaluar e kemi parë se prej 7miljonë janë shkuar suficit por armiku kryesor i joni po është suficiti në raport me ecurin që e keni 17.49% nëse e shumëzohmë me 4 i bije dikund 70% ku po bien përqindja e njëjtë e vitit të kaluar a është rrezik që me e pas suficitin mbi 25%.

Drejtor për Zhvillim Ekonomi – Buxhet e Financa z. Genc Ademaj – jo Niman rreziku nuk është që me e pas ketë suficit.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush te shtoj diçka rreth këtij raporti. Pasi që nuk ka diskutime tjera.

Kalojmë në piken tjetër.

23 anëtar prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës së 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga viti 2022, nga fondi burimore 22.

Drejtore për Zhvillim Ekonomi – Buxhet e Financa z. Genc, benë prezantimin dhe sqarimin e Bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga viti 2022, nga fondi burimore 22.

Niman Begiraj – ri funksionalizimi i ndërmarrjes Stacioni i Autobusëve po thotë që është obligim nga viti i kaluar me vendimin e kuvendit 50 mijë euro por ky vendim është shfuqizuar në dhjetor, tash a duhet edhe një here me e votuar këtë apo çfarë me bë . ka qen një gabim i kodit buxhetor.

Drejtore për Zhvillim Ekonomi – Buxhet e Financa z. Genc Ademaj – sqaron, ne nuk e kemi as një problem ligjor për subvencionimin e ndërmarrjeve tona lokale.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka,

Pasi që diskutime tjera nuk ka

Hedh në votim

Miratohet me 19 vota për, dhe 3 abstenim

Të pranishëm 22 anëtar të Kuvendit të Komunës

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken radhës , Shpallja në diskutim publik e Projekt – Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Punës në Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (SHPMPF).

Agron Gashi – përshëndet të gjithë të pranishmit, pasi qenka edhe drejtoresha inicuesja e kësaj Rregullore, sepse kemi marrë praktika me hershme se iniciuesit e asaj çështje. Nëse mundet drejtoria e mirëqenës Sociale ta na jep një raport se si është gjendja momentale në atë shtëpi.

Drejtoresha për Shërbime Sociale, znj. Merita Bytyqi - përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Propozim – Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private.

Kryesuesi i Kuvendit - A ka dikush diçka?

Pasi që diskutime tjera nuk ka

Hedh në votim

Miratohet unanim

Konstatohet që 22 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken tjetër, Planin Lokal të Veprimit për Transparencë të përmirësimi sipas modelit nga MAPL.

A ka dikush diçka rreth këtij plani

Pasi që diskutime nuk ka

Hedh në votim

Miratohet unanim

Konstatohet që 22 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e fundit Pyetje nga anëtarët e Kuvendit. A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Niman Beqiraj – kam këto pyetje pyetja 1. Për zjarrfikësit e komunës së Istogut kam qen në vizite atje ata profesionalisht janë shumë të përkushtuar të gatshëm për të shpëtuar qytetaret e komunës ton nga rreziqet me zjarrin që kushdo që ka pasur punë me zjarrin e din edhe rendësin e zjarrfikësve, kërkesa e par nga ta ishte kujdes ku po ulesh se mund ti dëmtosh pantallonat se komplet ato mobile ishin shumë të vjetra me gjilpëra e me tela të dalur sa ishin prej kohës së Spanjollve kur jua kanë dhurua ishte një inventar në gjendje të mjerueshme, me mure e me dritare të prishura ku kishte nevojë për renovim, aty kishte vllag myk, mbahet kujdestari 24 orësh aty dhe së pari duhet me u sigurua edhe shëndeti i tyre, andaj ju ftoj që të dilni pak edhe jashtë zyrave e të cilat i mirëmbani vit pas viti pom kujtohet edhe një diskutim. A e kini në plan ose mundësi që shpejt të investoni në këtë objekt. Sipas zjarrfikësve në fushat kryetar ju ki premtuar 20 mijë euro investime kur doni me jua dhen ato. Sipas zjarrfikësve drejtorja e tyre nuk ka buxhet, e buxheti i tyre a shkon ne drejtorin e Shërbimeve Publike pra nifar burokracie mu dokt mu e pa nevojshme e qe mbahet sekrete edhe shuma nuk dihet sa shpenzohen e ku shkojnë ato mjete nuk po them që mund të keq përdoren por institucioni nuk ka mundësi me planifikuar asgjë sepse nuk e din sa mjete i ka nuk ka kod buxhetor të tyre madje as për pare të imta një peti kesh se me ju dashtë atyre një poq elektrik me e ndërrua ose duhet me e ndërrua me pare të veta ose me nejt në terr kërkesa nga ta është që t'ju kthehet kodi buxhetor në komunë të behet kërkesë të kthehet që të dihet sa ka mjete në mënyrë që të bëjmë kërkesë të bazuar dikund shkoni takoni ata takoni shefin e tyre dhe përfshiheni në KKSB aktualisht operojnë me kamion të vjetruar të vitit 1974 ku shpejtësia maksimale duke rrezikuar jetën e tyre shkon 80 h. E shumë probleme tjera, edhe gypi për shpëtim emergjent është i shqyer, me ndodh një zjarr ata nuk kanë gyp mungojnë mjetet elementarë që janë në gjendje të vjetruar siç janë dorezat, uniformat, betterit, a e kini në plan me i gjet mjetet e nevojshme e me investuar me këto automjete, apo me gjet zgjedhje nga donatorët e ndryshëm apo me i ble siç i kini blerë për administratën komunale.

Në Istog i kemi 13 zjarrfikës por me ligj duhet të jen dikund 25. Kam edhe një kërkesë disa komuna tjera ndaj edhe shujta ditore për zjarrfikësit arsyeja pse po e përmendi është se ata mbajnë turne të gjithë 24orë pra brenda 24orve kur i ki dy veta në ndërrim njeri duhet ta bjer bukën e tjetri të rri të telefoni por e rëndësishme është që ti ndahet shujta ditore edhe këtyre që të paktën kasavetin e kësaj të mos e kenë. Banoret e objektit

banesor përball pompës së vjetër të benzinës rruga "Ibrahim Rugova" nr.74, banoret kanë bere kërkesë që të ju kthehet shenja e parkingut vetëm për banoret e objektit vetëm se me parë ishte aty dhe është larguar me protekstin që tani me rruga për shkak të çështjes është dy kahore mirë po ata tregojnë që ajo rrugë ishte edhe me herët dy kahore kjo bën pjesë në rrugët e karakterit të qetë ku shpejtësia duhet të jetë 20 kilometra në orë në kushte të tilla ndërkaq me njerëzit kompetent që i kemi pasur në bazë të ligjit tregoj që rruga duhet të jetë se paku 5 metra larg objektit ndërsa aty janë direkt në rrugët si të qelet dera e banesës, ligji për banesat e specifikon këtë çështje shumë mirë.

Bashkësia lokale e Vrellës po mendoj edhe me ato fshatrat përreth po edhe fshatrat me shumë nuk e kanë as edhe një sall të vetme sportive ose një fush ku rinia kish pas një vend me u merr me aktivitetet sportive rinore andaj shpesh e kam ber pyetjen për sallën e sportit në Vrellë që është një projekt që është duke shkuar dem ndoshta po e përmendi shpesh por kjo është e domosdoshme sepse po shkatërrohet edhe siç e kam thënë edhe një here sipas banorëve është strehe për narkoman që po e rrezikon rinin. Kam pyetur në ministri dhe kanë thënë që memorandum i parë në mars 2017 ka pas afat me u implementuar 2018 nuk ka ndodhur është nënshkruar memorandum i dytë në 2018 prape me u implementuar 2020 nuk ka ndodhur, është nënshkruar një aneks memorandum i tret në vitin 2021 për me u implementuar gjate 2021 prape nuk ka ndodhur kontrata ka qen me komunën e Istogut në vitin 2017 është zgjatur disa here zgjatja e fundit ka qen gjate vitit 2021 pra buxheti i planifikuar për vitin 2022 e ka pasur prape të planifikuar prej qeveris 750 mijë euro në total me qëllim të përfundimit mirë po nuk ka pas as një lëvizje sepse nuk ka pas planifikim për 2023. Çka po ndodh me këtë sall nëse jo salla a është në plan që të paktën në një periudhë të afërt të investoni në ndonjë fushë që të kemi mundësi rinia ti zhvillojnë aktivitetet e tyre.

Objekti i qerdhes së vjetër në fshatin Vrellë ne si fshat jemi të interesuar që atë objekt ta bëjmë për nevoja të fshatit, propozojmë që të mbani një dëgjim me qytetarët në fshatin Vrellë që të merrni mendimet e qytetarëve se çka të veprohet me atë objekt.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron rreth kushteve, në kohen që ishte drejtor i Shërbimeve Publike.

Niman Beqiraj – kërkoj që ta ftojme dikun nga zjarrfikësit që të vijë këtu dhe të tregoj për kushtet dhe gjendjen e tyre.

Kryetari i Komunës – buxhetin për zjarrfiksa e menaxhon drejtorja e Emergjencave, petikesh me nuk ka një petikesh është për krejt institucionin.

Sot para se me ardh në mbledhje drejtori e ka pru me e shpall në procedur kontratën për mirëmbajtjen e pajisjeve motorike dhe tjera. 20 mijë euro janë të planifikuara për renovim të objektit të zjarrfikësve. Po ashtu sqaron rreth pyetjeve tjera.

Drejtori i Emergjencave, z. Xhevat Demaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, sqaron rreth pyetjeve të lartcekura.

Agron Gashi – i kam disa pyetje për drejtorin e Arsimit, qerdhet në komunën e Istogut dihet që nuk ka hapsir të mjaftueshme për qerdhet, është premtuar që do të ketë qerdhe për çdo fëmije në komunën e Istogut përveç këtyre projekteve aktuale që janë a ka diçka planifikim me e shtuar numrin e tyre sepse qytetarët po hasin në probleme sidomos edhe me kushtet e konkursit kur dy prind janë në punë njeri nuk është në punë, pastaj ka kërkesa që nuk janë punë grat duan të avancojnë në karriere me shkuar në universitet

dhe nuk kanë ku me i angazhuar fëmijët, ka një burokraci mes poentimeve të rregullores se tyre. A ka me u shtuar numri i qerdheve a ka me pas qerdhe për çdo fëmije.

Fëmijët me nevoja të veçanta, është hapur një konkurs për fëmije me nevoja të veçanta po ka kërkesa akoma ka kërkesa kur një asistent është me tre ose katër nxansa dhe është problem me ata fëmije me shkuar, kështu që a ka me pas shtesë punëtor për këta fëmijë. Parkingu publik, a e ka komuna në plan me e ber një parking të mirëfillta në komunën e Istogut. Tash me mbylljen e rrugëve dhe shesheve tash po e shohim se veç janë duke u parkuar veturat po zvogëlohet pjesa e parkingut deri sa të del në tenderim pjesa që janë liruar parkingjet në qendër të sporteve shihet se ka problem edhe për parking sidomos në pjesën e qendrës ose njerëzit që vijën me i kryer shërbimet komunale edhe ne anëtarët e kuvendit po e kemi problem këtu po i dërgojmë veturat të banesat po dalin po na bërtasin qaty. Kështu që a ka plan konkret për parking.

Kërkesa e banorëve të fshati Dubravë rruga „Haki Hoti” aty janë mbi 20 shpi prej masluftes Rrugën e kanë shumë në gjendje të keqe e pa asfaltuar, nëse mund të dilni në teren dhe ta shihni kërkesën e atyre banorëve e me i par mundësit me e asfaltuar atë rrugë sepse janë disa shtëpi e bukur do banor që ka nevojë me e asfaltuar atë rrugë.

Kërkesa nga disa banor të rrugës „Shaban Manaj” ku ankohen për parkimin e veturave që parkohen automjetet nga qytetar që vine me krye shërbime në komunë ankohen për ndriçimin publik se nuk ka ajo pjesë dhe ajo pjesë që frekuentohet shumë nga banoret e lagjes „Blakaj dhe Bytyçi” siguria në rrugë është shumë e keqe sepse nuk ka trotuar dhe pjesa e rrugës nxinet me parkimin e veturave. Po ashtu edhe banesat që janë duke u ndërtuar kanë zënë rrugën me palët dhe me kamionët që janë duke punuar e kanë zen trotuarin dhe nuk kanë ka kalojnë qytetarët e asaj ane.

Kryetari i Komunës – jam në pajtim me ty të pjesa e rrugës „Shaban Manaj” me ndriçim, por jo për shkak të parkingut të veturave për shërbime të komunës. Të pjesa e keqpërdorimit të ndërtuesve po i kam par edhe vetë por me këtë duhet të merret Inspeksioni është detyrë e tyre.

Qerdhet në komunën e Istogut është premtim publik vend në qerdhe për secilin fëmijë që është premtuar brenda mandatit, të njëjtin problem siç e kemi me sallën në Vrellë e kemi edhe qerdhen se është mbetur në gjysmë ndërtimi i saj në Istog, që na kish lehtësuar edhe kriteret e rregullores që me muajt me e ber një klasifikim, është esenciale që fëmijët me shkuar në qerdhe dhe me e mbërri fazën e socializmit e të integritit. Zotim me shkrim kemi nga Ministria e Arsimit se shumë shpejt nderprehet kontrata shpallet procedura e re.

Fëmijët me nevoja të veçanta premtim publik është për secin fëmije që ka nevojë i kemi pasur 4 asistent tani i kemi 8 për momentin.

Drejtori i Shërbimeve Publike, z. Abedin Kabashi – përshëndet të gjithë të pranishmit, Rruga „ Haki Hoti” realisht është duke u mirëmbajtur ter kohen me zhavorr, por Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik e ka si prioritet që në vitet tjera ose në muajt në vazhdim ta shti si prioritet. Të rruga „Shaban Mani” nuk ka pasur njohuri se nuk ka ndriçim.

Ajshe Metaj – salla e sporteve tek pazari nuk është hera e parë që është diskutuar a keni planifikuar me ndërmarr diçka rreth kësaj sepse ato kulmet çdo dit po dëmtohen dhe gati po bien. Çka keni ndërmarr dhe a mundet komuna me bë diçka prek kujt është financuar dhe pse janë mbetur këto me ndërmarr diçka sepse ky objekt është në komunën ton sepse mos të ishte këtu nuk do ta shifshim as nuk do të interesoheshim.

Parkingjet, parkingu i autobusit aty afër Banana center nenstop po parkohen po nxihet parkingu dhe qytetaret po janë të obliguar ta kalojnë rrugën dhe çdo moment ata janë të rrezikuar, shumë e kemi pritur çështjen e Inspektorit por nuk u pa asgjë.

Kryetari i Komunës - qeshtëja e inspektorit po besoj se konkursi ka dalur dhe me zgjedhjen e tij besoj që kjo çështje e parkingjeve do të zgjidhet.

Arianit Selmanaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, rruga „Halil Baku“ në fshatin Kaliqan ka dëmtime është shembur një pjesë e rrugës aty si pasoj e kanalizimit që kanë ndodhur në fazën e parë kërkesa është për me e rinovuar aty atë pjesë sepse është dëmtuar koga fell, edhe disa kapak të shatkave janë demtuar me i rinovuar ata kapak se mundet me u bllokuar kanalizimi.

Projekti i kanalizimit në fshatin Kaliqan që quhet faza e dytë është lagja Ukaj, Sejday edhe Metaj. Të hogjd si themi ne me u bashkëngjit me lagjen Miranaj në Orruberd. Tash vera po vjen kur pritet rregullimi i kësaj rrugës.

Drejtori i Sherbimeve Publike, z. Abedin Kabashi – Rruga „Halil Baku“ kompania e kontraktuar vetëm se ka filluar meremetimin e të gjitha gropave dhe prishjet e asfaltit siguris se gjatë jave në vijim do të jetë edhe tek ju të gjitha rrugët e prishura do të rregullohen. Edhe për puseta e kemi kompaninë që e bën riparimin dhe ndërrimin e pusetave kjo do të rregullohet shumë shpejt.

Kanalizimi të lagja Ukaj, Sejday edhe Metaj është në projekt faza e dytë, projekti është duke u hartuar nga kompania projektuese.

Valbona Demaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, a behet vetem financimi nga komuna e Istogut për mirëmbajtjen dhe kujdesin e atyre të moshuarve aty bën pjesë me shumë se 80% e tyre janë që i përkasin komunave tjera a ka ndonjë ndihmë nga komunat tjera? Apo vetëm me shumën simbolike që e ka nga komuna jonë.

Merita Bytyçi – sa i përket rezidentëve në shtëpinë e pleqve aty në atë rezidenc, kjo shtëpi është regjionale kemi edhe nga komunat tjera rezident, ndërsa buxhetin e kemi nga Ministria, komuna e menaxhon buxhetin që ministria na ndanë në drejtorin e Mirëqenies Sociale.

Arta Balaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë për drejtorin e Urbanizmit disa banor të banesat mbrapa „Jafa Marketit“ duan ta dinë ku qëndrojnë qeshtjet pronësorë për ato banesa a janë në shitje apo do mbeten si deri me tani.

Drejtori i Urbanizmit, z. Dukagjin Hogjaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, njoftimi për ato banesa është publik dhe të gjithë ata që pretendojnë që kanë të drejtën e lejes së banese të aplikojnë është komisioni të gjithë të aplikojnë dhe marrin përgjigje nga komisioni.

Era Visoqi - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë për asfaltimin e Rrugës „Sarajeva në Dobrushë për shkak që është në gjendje shumë të keqe.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik, Buxhet e Financa, z. Genc Ademaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, lidhur me Rrugën „Sarajeva në Dobrushë ne jemi duke e hartuar

projektin është rrugë e paraluftës për këtë vit janë të planifikuara 70 mijë euro, rruga duhet të rindertohej komplet e re .

Visar Haxhiaja - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë për Rrugën e varrezave në Vrellë, varrezat janë rregulluar shumë mirë por pa rrugë problem me shkuar atje.

Kërkesa nga banoret për fushën e sportit në Vrellë është shumë e nevojshme se jemi kogja do banor aty dhe nuk ka fushë të sportit, kem nevojë për bari sintetik kemi ber edhe kërkesë.

Andi Xhuraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, në sheshin e ri „Ibrahim Rugova nuk është e vendosur as një ulës dhe as një shportë e berdhokut, kështu që kish qen mirë të vendosen këto. Edhe parkingu i atyre banorëve kish qen mirë që sa me shpejt me u gjet një zgjidhje për ta.

Pas heqjes së shtëpizave në shesh frekuentimi ka ren dukshëm, propozoj që ato shtëpiza të vendosen prape gjate muajve Qershor – Korrik.

Drejtori i Shërbimeve Publike, z. Abedin Kabashi – për ulëse edhe për shporta jemi duke e përgatitur projektin dhe besoj se shumë shpejt do të behet edhe vendosja e tyre në sheshin. Ndërsa parkingu ka për rreth parkingje ku mund ti parkojnë veturat.

Ardita Idrizaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kur fillojnë punimet për varreza faza e dytë në fshatin Lubozhd po ashtu dua të pyes kur fillojnë punimet e kanalizimit në fshatin Lubozhd në lagjen Idrizj të shtëpitë nalt?

Drejtori i Shërbimeve Publike, z. Abedin Kabashi – për këtë vit nuk është e projektuar, vendi është rregulluar, aty nevojitet vetëm pjesa përball varrezave me e rregulluar edhe një hapsir për parking.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush tjetër diçka ?

Falënderon të gjithë për durimin qe patën, dhe kontributin e dhëne,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.

Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:50

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

